



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1880/5 prot.

Datë 26.09.2022

**V E N D I M**

**Nr. 925/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.09.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SI & CO COMPANY” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-33686-06-21-2022, me objekt: “*Loti 2 “Blerje transformatore fuqie nga 250kv-630kv me tension primar 6kV dhe 10kV” me fond limit 112,440,000.0 (njëqind e dymbëdhjetë milion e katërqind e dyzetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.07.2022 nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Tiranë.*”

**Ankimues:** Operatori ekonomik “SI & CO COMPANY” SHPK  
Adresa: Rruga “Qemal Stafa”, ndërtesa nr. pasurie 3/252-N7, ZK 8140, dyqani D-07

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria Rajonale e OSSH Tiranë  
Adresa: Rruga “Reshit Petrela” Përballë Dispanserisë, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021

*“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” , Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”,*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorit ekonomik janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tij duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Ankimuesi, për ankesën e protokolluar pranë KPP me nr.1880 prot., datë 30.08.2022, nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, ndërkohë për ankesën e protokolluar pranë KPP me nr.1956 prot., datë 09.09.2022, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 22.06.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-33686-06-21-2022, me objekt: “Loti 2 “Blerje transformatore fuqie nga 250kv-630kv me tension primar 6kV dhe 10kV” me fond limit 112,440,000.0 (njëqind e dymbëdhjetë milion e katërqind e dyzetë mijë) lekë pa

TVSH, zhvilluar në datën 22.07.2022 nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Tiranë.

II.2. Në datën 25.08.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

“Berik Europe” SHPK	96,655,000 lekë, skualifikuar
“SI&CO Company” SHPK	100,500,000 lekë, skualifikuar
“BOE “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” & “Dule”SHPK	101,100,550 lekë, kualifikuar
“DABAR” SHPK	104,569,140 lekë, kualifikuar
“VIBTIS” SHPK	107,997,663 lekë, kualifikuar
“AA&P” SHPK	109,055,000 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “SI&CO Company” SHPK është skualifikuar me argumentin:

*Nuk ka plotësuar kriterin e vecante të kualifikimit pika 2.2 Kapaciteti teknik: 2.2.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të paraqese dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

II.3. Gjithashtu, në datën 30.08.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e rivlerësimit të procedurës së mësipërme të prokurimit, (e njëjta renditje si në vlerësimin e parë) si më poshtë:

“Berik Europe” SHPK	96,655,000 lekë, skualifikuar
“SI&CO Company” SHPK	100,500,000 lekë, skualifikuar
“BOE “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” & “Dule”SHPK	101,100,550 lekë, kualifikuar
“DABAR” SHPK	104,569,140 lekë, kualifikuar
“VIBTIS” SHPK	107,997,663 lekë, kualifikuar
“AA&P” SHPK	109,055,000 lekë, skualifikuar

II.4. Referuar Sistemit Elektronik të Prokurimeve rezulton, se në datën 31.08.2022 është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.5. Në datën 30.08.2022 nëpërmjet sistemit të ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. ankimi elektronik A/2022/2503 dhe me nr. 1880 prot., datë 30.08.2022 e operatorit ekonomik “SI & CO Company” SHPK duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1880/2 date 31.08.2022, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “SI & CO Company” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.7. Në datën 09.09.2022 nëpërmjet sistemit të ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. ankimi elektronik A/2022/2533 dhe me nr. 1956 prot., datë 09.09.2022 e operatorit ekonomik “SI & CO Company” SHPK duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1956/2 date 12.09.2022, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “SI & CO Company” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime

II.9. Në datën 14.09.2022, nëpërmjet shkresës nr. 1880/3 prot., me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesat e operatorit ekonomik “SI & CO Company” SHPK”, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesave, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.10. Në datën 19.09.2022 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1880/4 prot., shkresa nr. 3714/11 prot, datë 16.09.2022 e autoritetit kontraktor me lëndë: “*Vënie në dispozicion të dokumentacionit*”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet të cilës autoriteti kontraktor ka përcjellë informacion lidhur me procedurën e prokurimit, si dhe lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “SI & CO Company” ShPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.11. Në datën 19.09.2022 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1956/3 prot., shkresa nr. 3619/3 prot, datë 14.09.2022 e autoritetit kontraktor me lëndë: “*Kthim-përgjigje*”, drejtuar operatorit ekonomik “SI & CO Company” ShPK dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet të cilës autoriteti kontraktor ka përcjellë informacion lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “SI & CO Company” ShPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.12. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është paraqitur asnjë argument nga operatorë ekonomikë të interesuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Në datën 22.06.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-33686-06-21-2022, me objekt: “Loti 2 “Blerje transformatore fuqie nga 250kv-630kv me tension primar 6kV dhe 10kV” me fond limit 112,440,000.0 (njëqind e dymbëdhjetë milion e katërqind e dyzetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.07.2022 nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Tiranë.

III.1.1. Në datën 25.08.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

“Berik Europe” SHPK	96,655,000 lekë, skualifikuar
“SI&CO Company” SHPK	100,500,000 lekë, skualifikuar
“BOE “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” & “Dule”SHPK	101,100,550 lekë, kualifikuar
“DABAR” SHPK	104,569,140 lekë, kualifikuar
“VIBTIS” SHPK	107,997,663 lekë, kualifikuar
“AA&P” SHPK	109,055,000 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “SI&CO Company” SHPK është skualifikuar me argumentin:

*Nuk ka plotësuar kriterin e vecante të kualifikimit pika 2.2 Kapaciteti teknik: 2.2.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të paraqese dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

III.1.2. Gjithashtu, në datën 30.08.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e rivlerësimit të procedurës së mësipërme të prokurimit, (e njëjta renditje si në vlerësimin e parë) si më poshtë:

“Berik Europe” SHPK	96,655,000 lekë, skualifikuar
“SI&CO Company” SHPK	100,500,000 lekë, skualifikuar
“BOE “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” & “Dule”SHPK	101,100,550 lekë, kualifikuar
“DABAR” SHPK	104,569,140 lekë, kualifikuar
“VIBTIS” SHPK	107,997,663 lekë, kualifikuar
“AA&P” SHPK	109,055,000 lekë, skualifikuar

III.1.3. Referuar Sistemit Elektronik të Prokurimeve rezulton, se në datën 31.08.2022 është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

III.1.4. Në datën 30.08.2022 nëpërmjet sistemit të ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. ankimi elektronik A/2022/2503 dhe me nr. 1880 prot., datë 30.08.2022 e operatorit ekonomik “SI & CO Company” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.5. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: *a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe arsyet e skualifikimit të ankimuesit.*

III.1.6. Në datën 19.09.2022 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1880/4 prot., shkresa nr. 3714/11 prot, datë 16.09.2022 e autoritetit kontraktor me lëndë: “*Vënie në dispozicion të dokumentacionit*”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet të cilës autoriteti kontraktor ka përcjellë informacion lidhur me procedurën e prokurimit, si dhe lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “SI & CO Company” ShPK në procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton se ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik.

III.1.7. Neni 24, pika 1, “*Komisioni i prokurimit Publik*” i Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon shprehimisht se: “*Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.*”.

III.1.8. Neni 30, pika 1, “*Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik*” të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon shprehimisht se: “*Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e*

*prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.*

III.1.9. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.*

III.1.10. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. *Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. *Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.*

*2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.*

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. *Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

*Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.*

*“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”.*

Në nenin 115 *“Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik”* të Ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, parashikohet shprehimisht se: *1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë: a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin: i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar; ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës. 2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.*

Neni 118, *“Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik”* i Ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, parashikon shprehimisht se: *“1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.*

*2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

*a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimin të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;*

*b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;*

*c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;*

*ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;*

*d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankesë tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.*



III.1.11. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 10 ditë nga publikimi i **njoftimit të fituesit** ose i **njoftimit të anulimit**. Në rastin konkret, referuar verifikimeve në Sistemin Elektronik të Prokurimit, u konstatua se nga ana e autoritetit kontraktor është kryer publikimi i njoftimit të fituesit në datë 31.08.2022. KPP vëren, se operatori ekonomik ankimues “SI & CO Company” SHPK, ka dorëzuar ankesë nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 30.08.2022 dhe pranë autoritetit kontraktor ne datë 01.09.2022, ku kërkon shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij. Ndërkohë, nga verifikimi i informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, rezulton se autoriteti kontraktor nuk i ka pranuar pretendimet e parashtruara në ankesën e operatorit ekonomik “SI & CO Company” SHPK.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”, pasi nga ana e autoritetit kontraktor nuk ishte publikuar akoma njoftim-fituesi apo njoftimi i anulimit, për procedurën e prokurimit objekt-ankimimi.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në rastin kur nga ofertat e dorëzuara në procedurën e prokurimit nuk rezulton asnjë ofertë e suksesshme, ose kur operatori ekonomik kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikim/skualifikimin e operatorëve të tjerë, nis ditën e publikimit të njoftimit të anulimit dhe ditën e publikimit të njoftimit-fituesit dhe përfundon në ditën e 10-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk ka filluar akoma për sa kohë nuk është kryer publikimi i njoftimit të fituesit për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

Për sa më sipër, ankesa e depozituar nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave, datë 30.08.2022 numër A/2022/2503, protokolluar në Komisionin e Prokurimit me nr.1880 prot., datë 30.08.2022, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues,

që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dy institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “ Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “SI & CO Company” SHPK në ankimin elektronik numër A/2022/2533, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.1956 prot. datë 09.09.2022, për skualifikimin e tij në procedurën e sipërcituar me arsyetimin se: “ [...] Oferta jonë është skualifikuar me pretendimin se autoriteti kontraktor : “Nuk ka plotësuar kriterin e veçantë të kualifikimit pika 2.2 kapaciteti teknik 2.2.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

Fakti dhe e vërteta është se ne e kemi plotësuar kriterin e veçantë pika 2.2 kapaciteti teknik 2.2.1 dhe këtë gjë e vërtetojmë me faturat që kemi paraqitur elektronikisht në llogarinë e AK në sistemin e APP-së ashtu siç kërkohet dhe siç është përcaktuar me ligjin 162/2020 “Për prokurimin Publik” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”.

[...]1. Dokumenti i emërtuar “Faturë si co.pdf” është një faturë shitje e realizuar me sektorin privat dhe lexohet mëse qartë që shoqëria jonë ka shitur një transformator 40/50MVA i cili është një transformator i tensionit të lartë dhe i një fuqie të madhe sepse kutimi 40/50MVA është: “dyzet ose pesëdhjetë mega volt amper nga 6.05 kv deri në 115 kv kur mallrat që prokurohen janë transformatorë nga 250kva(kilo volt amper) deri në 630kva(kilovoltamper) dhe tension 6kv,10kv dhe maksimumi 20kv[...].

2. Dokumenti i emërtuar “SI&Co Company ShPK pdf” është një faturë shitje e realizuar me sektorin privat dhe lexohet mëse qartë që kompania jonë ka shitur muftë TM të tensionit 12kv në vlerën 21,411,450 (njëzet e një milion e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSh. Ju sqarojmë se materialet e quajtura muftë janë materiale elektrike që përdor OSSH-ja për riparimin e kabujve të tensionit të mesëm apo për bashkimin e kabujve me njëri tjetrin si dhe për të izoluar pikëlidhjet e kabujve të rrejtit me kabujt dalës të transformatorëve. [...].

[...]3. Dokumenti i emërtuar faturë nr. 10 dt. 3.3.2021 pdf është një faturë shitje me një kompani tjetër ose e thënë ndryshe shitje në sektorin privat. Në faturë vihet re fare qartë që janë shitur nga shoqëria jonë pjesë këmbimi nga më të ndryshmet në vlerën 4,471,000. Transformatori është i përbërë nga pjesë të ndryshme ku veshja e jashtme është prej metalit të hekurit, me në brendësi kemi vajin e transformatorit që luan rolin e izoluesit dhe të ftohësit dhe në qendër kemi bërthamën prej hekuri dhe mbështjelljen me tela alumini ose pështjella e aluminit e cila ka dhe rolin kryesor. [...].

[...]Me anë të këtyre tre faturave ne vërtetojmë se plotësojmë kriterin e veçantë pika 2.2 kapaciteti teknik 2.2.1 sepse shuma totale e tre faturave bashkë pa TVSh është 48,612,450 9dyzet e tetë milion e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSh ndërsa vlera e 40% e vlerës së fondit limit është 44,976,00 lekë pa TVSh. Jo vetëm që e plotësojmë vlerën e 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet por vlera e faturave të shoqërisë tonë është 3,636,450 lekë pa TVSh më e madhe se 40 % e vlerës së kontratës që prokurohet[...].

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.2.1 përcaktohet se:

**2.2.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “SI & Co Company” ShPK, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, rezulton, se është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Faturë tatimore shitje nr. 10 dt. 03.03.2021 ku operatori ekonomik “SI&Co Company” ShPK i ka shitur shoqërisë “Gajdi Company” ShPK në cilësinë e palës blerëse mallin pjesë këmbimi, në vlerën totale të faturës 4,471,000 pa TVSh.

- Faturë tatimore shitje nr. 9, datë 19.05.2020 ku operatori ekonomik “SI&Co Company” ShPK i ka shitur “Shërbimit Informativ Kombëtar” në cilësinë e palës blerëse mallin pjesë këmbimi për automjetet e SHISH, në vlerën totale të faturës 2,195,000 pa TVSh.
- Faturë tatimore shitje nr. 1, datë 31.07.2019 ku operatori ekonomik “SI & Co Company” ShPK i ka shitur shoqërisë “Çaci” ShPK në cilësinë e palës blerëse: transformator 40/50 MVA-copë 1, në vlerën totale të faturës 22,730,000 pa TVSh.
- Faturë tatimore shitje nr. 43, datë 06.08.2020 ku operatori ekonomik “SI & Co Company” ShPK i ka shitur shoqërisë “Allmeta 02” ShPK, në cilësinë e palës blerëse-mallin muftë TM 12 kv, në vlerën totale të faturës 21,411,450 pa TVSh.

III.2.3. Në kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues autoriteti kontraktor argumenton se:

*Në referim të dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik për të provuar përvojën e mëparshme rezultoi:*

*Theksojmë së pari se regjistrimi i procedurës në SPE (CPV) është bërë me kodin si pajisje dhe makineri dhe jo si material elektrik.*

1. *Faturë tatimore shitje nr. 43 dt., 06.08.2020 ku shoqëria “Si&Co Company” ShPK i ka shitur shoqërisë “Allmeta 02” ShPK, në cilësinë e palës blerëse-mallin muftë TM 12 kv, në vlerën totale të faturës 21,411,450 pa TVSh.*

*Malli i përcaktuar në këtë faturë: Muftë TM 12 kv nuk është në përputhje me objektin e prokurimit “Blerje transformatorë fuqie për kabina elektrike” dhe kjo faturë nuk përmbush kriterin e furnizimeve të mëparshme, të ngjashme. Theksojmë se materialet elektrike nuk bëjnë pjesë-përfshihen në grupimin e pajisjeve elektrike. Pra nuk janë mallra të ngjashëm me mallrat objekt prokurimi.*

2. *Faturë tatimore shitje nr. 10, dt. 03.03.2021 ku shoqëria “Si&Co Company” ShPK i ka shitur shoqërisë “Gajdi Company” ShPK në cilësinë e palës blerëse: mallin pjesë këmbimi në vlerën totale të faturës 4,471,000 pa TVSh.*

*Malli i përcaktuar në këtë faturë, nuk është i ngjashëm me mallrat objekt prokurimi, materiale të ndryshme dhe jo pajisje elektrike nuk është në përputhje me objektin e prokurimit “Blerje transformatorë fuqie për kabina elektrike” dhe kjo faturë nuk përmbush kriterin e furnizimeve të mëparshme të ngjashme.*

3. *Faturë tatimore shitje nr. 1, datë 31.07.2019 ku shoqëria “SI & CO Company” ShPK i ka shitur shoqërisë ÇAÇI ShPK në cilësinë e palës blerëse: Transformatorë 40/50 MVA copë një, në vlerën totale të faturës 22,730,000 pa TVSh.*

*Malli i përcaktuar në këtë faturë është: Transformatorë 40/50 MVA është në përputhje me objektin e prokurimit Blerje transformatorë fuqie për kabina elektrike dhe kjo faturë përmbush kriterin e furnizimeve të mëparshme, të ngjashme, pasi është mall i ngjashëm me mallrat objekt prokurimi. Por vlera e faturës tatimorë të shitjes 22,730,000 pa TVSh është më e vogël se vlera 40 % e fondit limit = 44,976,000 lekë pa TVSh.*

4. Faturë tatimore shitje nr. 9, datë 19.05.2020 ku shoqëria "Si&Co Company" ShPK i ka shitur shoqërisë Shërbim Informativ Kombëtar sh.p.k në cilësinë e palës blerëse: mallin-pjesë këmbimi për automjetet e SHISH, në vlerën totale të faturës 2,195,000 pa TVSh.

Malli i përcaktuar në këtë faturë:-Pjesë këmbimi për automjetet e SHISH (nuk janë mallra të ngjashëm me mallrat objekt prokurimi) nuk është në përputhje me objektin e prokurimit "Blerje transformatorë fuqie për kabina elektrike" dhe kjo faturë nuk përmbush kriterin e furnizimeve të mëparshme, të ngjashme.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës tuaj, vlerësojmë se ajo nuk është e drejtë dhe nuk merret parasysh.

III.2.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 4, 5 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës."

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: "3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..."

Në nenin 40 pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, përcaktohet se: "4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të

*një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.”*

III.2.4. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik “SI & CO Company” ShPK, në përmbushje të kriterit për furnizimet e mëparshme të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, nga krahasimi i situacioneve përfundimtare të furnizimeve të realizuara nga operatori ekonomik “SI & CO Company” ShPK, me specifikimet teknike dhe relacionin teknik të objektit të prokurimit, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës së projektit objekt të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Kështu, referuar specifikimeve teknike, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se: **“Ky specifikim mbulon transformoret e shperndarjes 6/0.4; 10/0.4; 20/0.4 dhe 35/0.4 kV per perdorim ne ambient te brendshem dhe te jashtem” , Transformatori i shperndarjes do të jetë transformator i mbushur me vaj i tipit te mbyllur hermetikisht ONAN.**

*Transformatorët do të kete vlere nominale te tensionit prej -/0.4 kV. Regullatori i tensionit i cili vendoset ne anen TM, do te jete plus-minus 5 % me 2.5 % ne cdo shkalle. Grupi i lidhjes do të jetë sipas aneksit 1. Daljet TM dhe TU te transformatorit do te jene per kablo. Temperatura maksimale e lejuar do te jete:*

- *Vaji 600 C (pjesa e sipërme)*
- *Peshjtjellat 650 C (shtresa më e nxehtë) Transformatori i fuqisë do të jetë i ndërtuar në atë mënyrë që të përmbushë kërkesat e mëposhtme:*
- *Të ketë cilësinë për t'i rezistuar çdo tronditjeje gjatë transportit dhe instalimit*
- *Të sigurojë shpërndarje efikase të nxehtësisë*
- *Të jetë i papershkueshen nga uji dhe vaji i nxehtë*
- *Të kete zhurma dhe dridhje deri në një nivel te lejueshem.*

*Jetegjatesia teknike duhet te jete 35 vjet. [...]*

Në këtë mënyrë, KPP vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit lidhet me pajisje elektrike, aktive afatgjata.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmimeve për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike ligjvënësi në nenin 40 pika 4 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter mund të të përmbushet me dorëzimin e një kontrate të ngjashme me një vlerë jo më të madhe se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës dhe që është realizuar edhe me furnizime të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të mëparshme të ngjashme e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është jo më e madhe se 40 % e vlerës limit të kontratës së prokurimit. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë

nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërkimit të dokumentacionit është brenda periudhës tre vjeçare sikundër parashikohet edhe në Vendim të Këshillit të Ministrave.

Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme, nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë furnizimi-mallra, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit (*ratio legis*) të kërkesës për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

III.2.6. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt-shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kushtin për të paraqitur dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Nga shqyrtimi i informacionit të depozituar me shkresën nr. 1956/3 prot., datë 14.09.2022 me objekt: “Kthim-përgjigje” rezulton se, nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës është konkluduar që dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik pjesëmarrës “Si&CO Company” SHPK në procedurën e prokurimit, në përmbushje të kriterit sa më sipër cituar, nuk është në përputhje me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Konkretisht, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës në informacione depozituar pranë KPP-së, në lidhje me këtë pretendim të ankimuesit “Si&CO Company” SHPK, ka argumentuar se “Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk vërtetohet se ky ofertues ka eksperiencën e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës”. “

Referuar kriterit 2.2.1. në dokumentet e tenderit, për dëshmitë e kontrata të ngjashme, është kërkuar që “Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Komisioni mori në shqyrtim faturat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues: **Faturë nr. 10, datë 03.03.2021** ku konstatohet se shoqëria “SI & CO Company” ShPK i ka shitur shoqërisë “Gajdi Company” ShPK, në cilësinë e palës blerëse mallin pjesë këmbimi në vlerën totale të faturës 4,471,000 lekë pa TVSh, ku është evidentuar specifikim i hollësishëm i artikullit të faturës “pjesë këmbimi” dhe nga ku rezulton se mallrat objekt i kësaj fature janë pjesë këmbimi për automjete, *si Bateri, dinamo, disk freni, ferrota, filtër ajri, filtër nafte, kryq trasmesioni, grup timoni, motorino, rrip dinamoje, radiator uji, tuba tepric nafte, tub uji, ferrota ,kavo freksioni, kavo gazi etj.* Referuar objektit të kontratës “Loti 2 “Blerje transformatore fuqie nga 250kv-630kv me tension primar 6kV dhe 10kV”, Komisioni gjykon, se malli i përcaktuar në këtë faturë nuk është i ngjashëm me mallrat objekt-prokurimi dhe se nuk përmbush kriterin e furnizimeve të mëparshme të ngjashme, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me pajisje mekanike, jo të ngjashme me mallin objekt-prokurimi.



Në përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik “Si & Co Company” SHPK ka dorëzuar gjithashtu **Faturë nr. 9, datë 19.05.2020** ku shoqëria “SI & CO Company” SHPK i ka shitur “Shërbimit Informativ Kombëtar” në cilësinë e palës blerëse, mallin pjesë këmbimi për automjetet e SHISH, në vlerën totale të faturës 2,195,000 pa TVSh. Komisioni gjykon, se ashtu siç u argumentua më sipër malli i përcaktor në këtë faturë “pjesë këmbimi për automjete” nuk është në përputhje me objektin e prokurimit dhe se nuk përmbush kriterin e furnizimeve të mëparshme, të ngjashme.

Referuar faturës tatimore shitje **nr. 1, datë 31.07.2019** ku shoqëria “SI & CO Company” ShPK i ka shitur shoqërisë “ÇAÇI” ShPK në cilësinë e palës blerëse: transformatorë 40/50 MVA, copë 1 (një), në vlerën total të faturës 22,730,000 pa TVSh. Komisioni gjykon, se malli i përcaktuar në këtë faturë është mall i ngjashëm me mallin objekt-prokurimi dhe përmbush kriterin e furnizimeve të mëparshme të ngjashme, por kjo vlerë pa TVSh nuk arrin të plotësojë kriterin e veçantë të kualifikimit për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës (40% \*fondi limit 112,440,000 = 44,976,000 lekë pa TVSH).

Fatura tatimore shitje **nr. 43, datë 06.08.2020** ku shoqëria “SI & CO Company” SHPK i ka shitur shoqërisë “Allmeta 02” ShPK, në cilësinë e palës blerëse-mallin Muftë TM 12 kv, në vlerën totale të faturës 21,411,450 pa TVSh, Komisioni gjykon, se malli i përcaktuar në këtë faturë, nuk janë mallra të ngjashëm me mallrat objekt-prokurimi, pasi malli i përcaktuar në faturë MUFTE TM 12 kv është material elektrik, por jo pajisje elektrike siç është objekti i prokurimit, por edhe sikur të konsiderohet se e përmbush kriterin e furnizimeve të mëparshme të ngjashme, vlera e të dyja faturave: faturë tatimore e shitjes nr. 1, datë 31.07.2019 në vlerën 22,730,000 lekë pa TVSh dhe fatura tatimore e shitjes nr. 43 datë 06.08.2020 në vlerën 21,411,450 lekë pa TVSh = 44,141,450, më e vogël se vlera 40 % e fondit limit **44,976,000** lekë pa TVSh.

Komisioni gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor, që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh

operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “SI & Co Company” SHPK, nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit në lidhje dëshmitë për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës nga autoriteti kontraktor, qoftë me një ent publik apo sektorin privat.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “SI & Co Company” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën nr.1880 prot., datë 30.08.2022 të operatorit ekonomik “SI&CO Company” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-33686-06-21-2022, me objekt: “Loti 2 “Blerje transformatore fuqie nga 250kv-630kv me tension primar 6kV dhe 10kV” me fond limit 112,440,000.0 (njëqind e dymbëdhjetë milionë e katërqind e dyzetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.07.2022 nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Tiranë.
2. Të mos pranojë ankesën nr.1956 prot., datë 09.09.2022 të operatorit ekonomik “SI&CO Company” SHPK për procedurën e sipërpërmendur.
3. Autoriteti kontraktor, lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SI & CO Company” SHPK për ankesën nr.1880 prot., datë 30.08.2022.

5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SI & CO Company” SHPK për ankesën nr.1956 prot., datë 09.09.2022.
  6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

